



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.206

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.5543 datë 12.12.2007	Për emërim ambasadori 11083
Vendim i KM nr.1547, datë 26.11.2008	Për miratimin e kontratës të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe “Idea Vlora” sha, për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e parkut industrial në Vlorë..... 11083
Vendim i KM nr.1686, datë 24.12.2008	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Lezhë të qarkut të Lezhës”..... 11084
Vendim i KM nr.1687, datë 24.12.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Ksamil të qarkut të Vlorës..... 11085
Vendim i KM nr.1688, datë 17.12.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurën e prokurimit të kryer nga këshilli i qarkut të Fierit, si autoritet kontraktor 11086
Vendim i KM nr.1689, datë 17.12.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar 11086
Vendim i KM nr.1690, datë 17.12.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” 11087

Vendim i KM nr.1692, datë 17.12.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.723, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar”	11088
Vendim i KM nr.1693, datë 24.12.2008	Për një shtesë në vendimin nr.21, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjendjes civile, në njësitë e qeverisjes vendore”.....	11088
Vendim i KM nr.1696, datë 24.12.2008	Për krijimin e fondit të kompensimit fizik, nga objekte shtetërore të “Albminiera” sha dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar	11089
Vendim i KM nr.1697, datë 24.12.2008	Për krijimin e Qendrës Kombëtare të Licencimit	11091
Vendim i KM nr.1701, datë 17.12.2008	Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni	11092
Udhëzim i MF dhe MPPTT nr.40, datë 24.12.2008	Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë	11103
Udhëzim i MB nr.1412, datë 12.12.2008	Për rregullat e numërimit të ndërtesave në fshatra, kur nuk ka mundësi të emërimit të rrugëve	11104
Urdhër i MB nr.1411, datë 10.12.2008	Për miratimin e modelit të adresës dhe radhën e vendosjes së elementeve të saj	11106
Urdhër i MB nr.1445, datë 22.12.2008	Për miratimin e rregullores “Për rregullat e punës në hartë për numërtimin e ndërtesave dhe përcaktimin e adresës së shtetasve nga bashkitë/komunat/njësitë bashkiake”.....	11107
Vendim i ERE nr.143, datë 29.12.2008	Për një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.13, datë 28.1.2008 “Për dhënien e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike” (parku eolik, projekti Visu dhe Terpan)	11112
Vendim i ERE nr.144, datë 30.12.2008	Për përcaktimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe, për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike.....	11113
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Ferat Bushi	11113
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Flamur Qerim Dautllari	11113
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Silvana Pera	11113
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Roland Gjyli	11114
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilia Shkira	11114
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Osman Veliraj	11114

DEKRET
Nr.5543, datë 12.12.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të neneve 92 pika “dh”, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Bujar Dida emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Japoni.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1547, datë 26.11.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE “IDEA VLORA”
SHA, PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN
DHE TRANSFERIMIN E PARKUT INDUSTRIAL NË VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, dhe të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe “Idea Vlora” sha-së, për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e parkut industrial në Vlorë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1686, datë 24.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.414, DATË 11.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.414, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Përmasat e pronave nr.262, 262/1, 262/2, 262/3, 262/4, 262/5, 262/6, 262/7, 262/9 e 262/11, në bashkinë Lezhë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në listën e inventarit të pronave të bashkisë Lezhë shtohen pronat me nr.1-216, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pronat e përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i transferohen bashkisë Lezhë.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lezhë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
81	Terrene sportive	Në pronësi
12-24,27-75,77-80,82-193,195-198,200-203,205,206,207-216.	Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte sip të gjelbëruara) dhe shërbime publike	Në pronësi

VENDIM
Nr.1687, datë 24.12.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KSAMIL TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Ksamil të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Ksamil të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.270, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ksamil të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ksamil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Komuna Ksamil

Lidhje nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11, 12	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
4	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
5	Prona që përdoren për ushtrimin funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
6	Varrezat publike	Në pronësi
29-53	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
64	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
13,14	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
18,19	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi

VENDIM

Nr.1688, datë 17.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT TË KRYER NGA KËSHILLI I QARKUT TË FIERIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e këshillit të qarkut të Fierit të shtyjë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 23 dhjetor 2008, për procedurën e prokurimit, për fondin 5 000 000 (pesë milionë) lekë, të parashikuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, për studimin “Masterplani i zonës turistike, ndërmjet derdhjes së lumit Seman dhe lumit Vjosë”. Për këtë objekt vlera e paradhënies të jetë në masën 10 për qind të vlerës së parashikuar në kontratë.

2. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe këshilli i qarkut të Fierit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1689, datë 17.12.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

a) Fjalja e fundit e pikës 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi, përfiton një pagesë, në masën 9200 (nëntë mijë e dyqind) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh, për masën e pagesës së kujdestarit, për muajin dhjetor të vitit 2008, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1690, datë 17.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 13 fjalët “...pikave 1 e 2...” zëvendësohen me “... pikës 1...”.

b) Pas pikës 13 të shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1. Kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi, përfiton një pagesë, në masën 9200 (nëntë mijë e dyqind) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, për masën e pagesës së kujdestarit, për muajin dhjetor të vitit 2008, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1692, datë 17.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.723, DATË 19.11.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E INVALIDIT TË PUNËS”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.723, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "... është 6000 lekë..." zëvendësohen me "... është 7000 (shtatë mijë) lekë..."

2. Efektet financiare, në masën 400 000 (katërqind mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për muajin dhjetor të vitit 2008, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 dhjetor 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1693, datë 24.12.2008

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.21, DATË 9.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
"PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË NUMRIT TË
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE, NË NJËSITË E QEVERISJES
VENDORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 58 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2008 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pasqyrën nr.2 "Qarku Dibër, zyra e gjendjes civile, komuna Selishtë", që i bashkëlidhet vendimit nr.21, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet një përgjegjës, shtesë e cila të reflektohet edhe në organikën e zyrave të gjendjes civile, në bashki e komuna.

2. Efektet financiare të përballohen nga të ardhurat e komunës.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1696, datë 24.12.2008

**PËR KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT FIZIK, NGA OBJEKTE SHETËTORORE TË
"ALBMINIERA" SHA DHE SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik dhe vënien në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të 32 objekteve shetëtorore të "Aibminiera" sha-së dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi të bëjë verifikimin përfundimtar të

pronësisë së truallit për objektet, përbërëse të fondit të mësipërm, ta përdorë fondin për kompensimin e pronarëve, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.

3. Pas verifikimit përfundimtar, të bërë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronat, të cilat rezultojnë me njohje apo kthim pronësie, të hiqen nga fondi i kompensimit fizik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

OBJEKTET E SHOQËRISË “ALBMINIERA” SHA DHE TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR, QË DO TË PËRFSHIHEN NË FONDIN E KOMPENSIMIT FIZIK

Nr.	Emërtimi	Institucioni	Nd/ja nga varet	Vendndodhja
1	Ndërtesa 1-katëshe e magazinës së gjeofizikës	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
2	Ndërtesë 2-katëshe magazinë+ kapanone auto	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
3	Zyrat e katit të parë	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
4	Ndërtesa e depos së qymyrit dhe zduktarisë	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
5	Magazinë nr.2 e oficinës	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
6	Oficina	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
7	Ndërtesë 1-katëshe e magazinës nr.1	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
8	Ndërtesë 1-katëshee magazinës me vinç ure (shtesë)	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
9	Ndërtesë 1-katëshe e magazinës me vinç urë	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
10	Ndërtesë 1 katëshe e magazinës së tubave	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Bulqizë
11	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel	Burrel
12	Oficina e ndërmarrjes	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel	Burrel
13	Zyra kati parë të ndërmarrjes	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel	Burrel
14	Magazinë 1 katëshe e ndërmarrjes	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Burrel	Burrel
15	Magazinë 1katëshe e ish-ekspeditës gjeologjike Peshkopi	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Bulqizë	Peshkopi
16	Kapanoni i automjeteve nr.1	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik	Rubik
17	Kapanoni i automjeteve nr.2	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik	Rubik
18	Kapanoni i autooficinës	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik	Rubik
19	Vendrojtë	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik	Rubik
20	Ndërtesë dykatëshe e laboratorit	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik	Rubik
21	Ndërtesë dykatëshe e zyrave (kati i parë)	Shërbimi gjeologjik shqiptar	Dega rajonale ndërm.shërbimit gjeologjik Rubik	Rubik
22	Menca e sektorit pusi nr.1	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera 1 xhabokike sek.III
23	Magazina e fabrikës	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera 1 xhabokike sek.III
24	Llambisteri pusi nr.1	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera 1 xhabokike sek.III
25	Menca e punëtorëve pusi nr.2	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera nr.2 Dervishaj
26	Dush e gardierobë pusi nr.1	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera 1 xhabokike sek.III
27	Dush e gardierobë pusi nr.2	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit	Miniera nr.2

			Memaliaj	Dervishaj
28	Llambisteri pusi nr.2	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera nr.2 Dervishaj
29	Salla e kompresorëve nr.2	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera nr.2 Dervishaj
30	Zyrat e fabrikës pusi nr.1	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera I xhabokike sek.III
31	Zyrat e sektorit pusi nr.2	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera nr.2 Dervishaj
32	Zyra + magazinë	Albminiera sh.a.	Ish-minierës qymyrgurit Memaliaj	Miniera I xhabokike sek.III

VENDIM
Nr.1697, datë 24.12.2008

PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës Kombëtare të Licencimit, që më poshtë do të përmendet QKL, si një institucion publik qendror, me seli në Tiranë, me personalitet juridik, në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (më poshtë ministri), e që financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. QKL-ja mbështet ministrin për përgatitjen e kuadrit, normativ dhe institucional, për trajtimin e licencave, të lejeve, nëpërmjet një sistemi me një ndalesë.

3. Veprimtaria e QKL-së drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, që emërohet nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Titullari i QKL-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

5. Titullari i QKL-së lirohet nga detyra për shkaqet dhe sipas procedurave të parashikuara në pikën 1 të nenit 21 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me vendim të ministrit.

6. Titullari i QKL-së u nënshtrohet dispozitave, që rregullojnë masat, procedurat disiplinore dhe vlerësimin e punës, të përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil, për institucionet e pavarura. Ministri është eprori direkt, në kuptimin e këtyre dispozitave.

7. Ankimi ndaj vendimeve të ministrit, të nxjerra në mbështetje të pikave 6 e 7 të këtij vendimi, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

8. Për nëpunësit e QKL-së zbatohen procedurat e përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil, përveç sa parashikohet ndryshe me këtë ligj. Titullari i QKL-së është eprori direkt, në përputhje me këto dispozita.

9. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të thjeshtë të QKL-së, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, u nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

10. Ankimi ndaj akteve të titullarit, të nxjerra në mbështetje të pikave 10 e 11 të këtij vendimi, bëhet drejtpërdrejt në gjykatë.

11. Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të nëpunësve të QKL-së, në fazën fillestare të krijimit, mbështetet nga shërbimet mbështetëse të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

12. Struktura dhe organika e QKL-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.

13. Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të disa institucioneve në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar, shtohet emërtimi “... Qendra Kombëtare e Licencimit”.

14. Numrit të punonjësve, të parashikuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, t’i shtohen dhe 20 vetë.

15. Buxheti për vitin 2009, për këtë institucion, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

16. Deri në rekrutimin e stafit të nevojshëm, shërbimet e financës, të llogarisë dhe të prokurimit të kryhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

17. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1701, datë 17.12.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E DHËNIES SË
AUTORIZIMEVE, PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË REJA GJENERUESE TË
ENERGJISË, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË
REJA GJENERUESE TË ENERGJISË, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI**

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin, vlerësimin dhe dhënien e një autorizimi për ndërtimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë, që nuk është objekt koncesioni.

2. Kjo rregullore është hartuar në përputhje me nenin 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Neni 2
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje janë burimet e reja gjeneruese të energjisë, ndërtimi i të cilave bëhet me financime private dhe që lidhen me rrjetet e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes.

2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zëvendësojnë ndonjë kompetencë të ndonjë autoriteti ose institucioni tjetër shtetëror ekzistues për të dhënë leje, pëlqimin ose çdo dokument tjetër që kërkohet për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3 Përcaktime

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

- “Aplikim” do të thotë çdo kërkesë e paraqitur nga një person për ndërtimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë sipas formës së përcaktuar në këtë rregullore;
- “Aplikues” do të thotë çdo person, që aplikon për një leje sipas kësaj rregulloreje;
- “Person” do të thotë një person fizik ose juridik;
- “Vetëprodhues” do të thotë një burim gjenerues i energjisë, ku jo më pak se 70% e prodhimit të të cilit përdoret për nevoja e tij vetjake;
- “Burim koogjenerues” do të thotë një burim gjenerues që prodhon nxehtësi dhe energji elektrike;
- “Pika e lidhjes” do të thotë pika fizike e lidhjes e përcaktuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), në të cilën burimi gjenerues do të lidhet me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes;
- “OST” do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- “OSSH” do të thotë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes;
- “Ministria përgjegjëse për energjinë” do të thotë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ose çdo ministri pasardhës e saj;
- “Ministër” do të thotë Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ose ministri përgjegjës për energjinë;
- “Studim parafisibiliteti” do të thotë një vlerësim paraprak i përafërt teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e një kapaciteti të ri gjenerues të energjisë;
- “Studim fisibiliteti” do të thotë një vlerësim i plotë teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e një kapaciteti të ri gjenerues të energjisë;
- “Autorizim” do të thotë një leje specifike e miratuar nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, që autorizon një person për ndërtimin e një burimi të ri gjenerues;
- “Autorizim paraprak” do të thotë miratimi i ndërmjetëm i dhënë nga ministria përgjegjëse për energjinë për vazhdimin e procedurave për marrjen e një autorizimi”;
- “Mbajtësi i autorizimit” do të thotë personi që merr një autorizim për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë sipas dispozitave të kësaj rregulloreje;
- “I deleguari përgjegjës” do të thotë një person fizik, që aplikon për një autorizim në emër të një aplikuesi sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI II PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR AUTORIZIM

Neni 4 E drejta për të aplikuar

1. Çdo person që zhvillon veprimtari tregtare sipas legjislacionit shqiptar mund të aplikojë për marrjen e një autorizimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë.

2. Çdo person i huaj, që kërkon të aplikojë për marrjen e një autorizimi, sipas kësaj rregulloreje, duhet të krijojë një filial ose zyrë përfaqësimi në Shqipëri sipas dispozitave të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe kërkesave të legjislacionit tatimor shqiptar.

3. Çdo aplikim sipas kësaj rregulloreje bëhet në ministrinë përgjegjëse për energjinë.

Neni 5

Delegimi i autoritetit të aplikuesit

1. Një aplikues mund të caktojë një person fizik ose juridik si të deleguar përgjegjës për të aplikuar për një autorizim për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e kësaj rregulloreje.

2. I deleguari pajiset me prokurën e aplikuesit për përfaqësimin e tij në veprimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe marrjen e autorizimit.

Neni 6

Forma e aplikimit

1. Çdo aplikim për autorizim, sipas kësaj rregulloreje, bëhet në formën e përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje dhe shoqërohet me dokumentet e parashikuara në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, ndryshe ai nuk do të shqyrtohet nga ministria përgjegjëse për energjinë.

2. Çdo aplikues duhet të bëjë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit në vlerën dhe numrin e llogarisë së ministrisë përgjegjëse për energjinë siç përcaktohet në aneksin B të kësaj rregulloreje.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar, ndërsa vërtetimet dhe deklaratat nga organe të tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

4. Çdo aplikim i shoqëruar me dokumentacionin përkatës do të paraqitet në dy kopje: një origjinale ose fotokopje e noterizuar, siç përcaktohet në pikën 3 të këtij neni, dhe një fotokopje tjetër e të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në këtë rregullore.

Neni 7

Dokumentacioni shoqërues që kërkohet për një autorizim

Çdo aplikim për një autorizim shoqërohet me dokumentet dhe/ose informacionin e mëposhtëm për identifikimin e aplikuesit:

1. Emri i aplikuesit;
2. Adresa e selisë së aplikuesit;
3. Administratori i shoqërisë;
4. Përfaqësuesi ose i deleguari përgjegjës (nëse ka);
5. Struktura organizative e shoqërisë;
6. Kapacitetet teknike, organizative dhe profesionale të shoqërisë;
7. Informacion për ndonjë veprimtari të ngjashme në sektorin e energjisë elektrike;
8. Numri i telefonit, faksit ose adresën e e-mail-it;
9. Numri i identifikimit personal të zyrës së taksave (NIPT);
10. Vërtetime për shlyerjen e taksave, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi;
11. Pasqyrat financiare të audituara të tri viteve të fundit të veprimtarisë ose kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së shoqërisë, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar.
12. Çdo dokument tjetër që ministria përgjegjëse për energjinë mund të kërkojë për të provuar këtë aftësi.

Neni 8

Të dhënat, informacioni i përgjithshëm për burimin gjenerues të energjisë dhe kriteret që duhet të plotësojë ndërtimi i tyre

a) Një aplikues paraqet në ministrinë përgjegjëse për energjinë, përveç dokumenteve dhe informacionit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje, të dhënat dhe informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

- tipin e burimit gjenerues të energjisë;

- kapacitetin e instaluar në MW;
 - numrin e njërive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapacitetin e tyre në MW;
 - prodhimin vjetor të energjisë elektrike në MWh;
 - afatin e pritshëm të vënies në punë;
 - jetëgjatësinë e pritshme të burimit gjenerues të energjisë;
 - numrin e orëve të punës në vit;
 - rendimentin e burimit gjenerues të energjisë;
 - standardet teknike të pajisjeve të burimit gjenerues të energjisë;
 - nivelin e tensionit në dalje të gjeneratorit;
 - skemën kryesore elektrike të burimit gjenerues të energjisë dhe lidhjen e tij me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes;
 - vlerën e parashikuar të investimit total;
 - vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë;
 - strukturën e propozuar të kapitalit dhe burimet e parashikuara të financimit të ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë;
 - programin e zbatimit të projektit;
 - përshtatshmërinë e pajisjeve të burimit gjenerues të energjisë me sistemin elektroenergjetik;
 - përlogaritjen e emetimeve të gazeve të efektit serë nga burimet gjeneruese dhe nëse ato janë në përputhje me normat europiane mjedisore;
 - një plan menaxhimi, që do të realizohet pasi të demontohet burimi gjenerues, në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje e kujdesshme e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, përfshirë përmirësimin e mjedisit mbas mbylljes së veprimtarisë.
- b) Kriteret që duhet të plotësojë objekti që do të ndërtohet, për të marrë autorizimin e ndërtimit janë:
- të garantojë se vënia në punë e këtij objekti nuk cenon sigurinë e sistemit tonë elektroenergjetik;
 - të sigurojë se ndërtimi dhe shfrytëzimi i këtij objekti nuk ndikon në mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së publikut;
 - të sigurojë se ndërtimi dhe shfrytëzimi i këtij objekti nuk ndikon në mbrojtjen e mjedisit;
 - të garantojë një përdorim racional të tokës dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare pas përfundimit të veprimtarisë prodhuese të objektit;
 - të sigurojë efikasitet të energjisë.

Neni 9

Të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike sipas tipit të burimit gjenerues të energjisë

Një aplikues paraqet në ministrinë përgjegjëse për energjinë, në varësi të tipit të burimit gjenerues të propozuar, përveç sigurisë për plotësimin e kriterëve të shprehura në germën “b” të nenit 8 të kësaj rregulloreje dhe të dhënat, informacionet dhe kriteret specifike të mëposhtme:

A) Për një termocentral (TEC):

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë (me cikël të thjeshtë, me cikël të kombinuar etj.) dhe parametrat teknikë të pajisjeve kryesore (kaldaja, turbina, motorë me djegie të brendshme, gjeneratorë, transformatorë);
- llojin e lëndës djegëse që përdor;
- efikasitetin termike, elektrike dhe totale të burimit gjenerues të energjisë;
- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- burimet e furnizimit me lëndë djegëse;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë konform normave të përcaktuara në kuadrin ligjor shqiptar.

B) Për një burim gjenerues të prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehtësisë (me koogjenerim):

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- llojin e lëndës djegëse;
- efikasitetin termike, elektrike dhe totale të burimit gjenerues të energjisë;

- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- kapacitetin termik dhe elektrik të burimit gjenerues të energjisë;
- destinacionin e nxehtësisë së prodhuar;
- kapacitetin termik të kaldajës mbështetëse, nëse ka;
- respektimin e normave mjedisore për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë konform normave të përcaktuara në kuadrin ligjor shqiptar.

C) Për një gjenerues me erë:

- të dhëna mbi potencialin e erës në zonën e propozuar;
- shpejtësia minimale dhe maksimale e shfrytëzueshme e erës;
- shpejtësinë mesatare vjetore të erës;
- tipin dhe lartësinë e kullës eolike;
- diametrin e rotorit të gjeneruesit;
- numrin e kullave, nëse do të jetë një park eolik;
- respektimin e normave mjedisore akustike dhe vizuale;
- të garantojë, që kur punon në paralel me sistemin tonë elektroenergjetik, në regjim maksimal dhe/ose minimal, nuk cenon qëndrueshmërinë e sistemit tonë elektroenergjetik.

D) Për një sistem fotovoltaiik:

- karakteristikat teknike të sistemit fotovoltaiik;
- rrezatimin diellor mesatar vjetor [$\text{kJ/m}^2 \text{ year}$];
- këndin optimal të përthyerjes të panelit diellor;
- sipërfaqen në metra katrorë të panelit të instaluar.

E) Për një burim gjenerues me biomasë:

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- llojin e biomasës;
- konsumin specifik të lëndës djegëse biomasë;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- mënyrën e sigurimit dhe furnizimit me biomase.

F) Për një vetëprodhues:

- teknologjinë e përdorur në burimin gjenerues të energjisë;
- llojin e lëndës djegëse;
- konsumin specifik të lëndës djegëse;
- fuqinë kalorifike të lëndës djegëse;
- sasinë e pritshme të energjisë, që do të konsumohet për nevojat e tij vetjake;
- sasinë e pritshme të energjisë, që do të absorbohet ose injektohet në rrjetin kombëta.

Neni 10

Studimi i parafisibilitetit

1. Aplikuesi paraqet një studim parafisibiliteti, që jep besueshmëri të mjaftueshme teknike, ekonomike dhe financiare të projektit të propozuar, si dhe ndikimin e tij mjedisor dhe social.

2. Studimi i parafisibilitetit, i paraqitur sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin:

a) Në terma teknike, studimi duhet të japë informacion lidhur me besueshmërinë teknike të projektit të propozuar dhe duhet të shoqërohet me paraqitjen e përgjithshme skematike të burimit gjenerues të energjisë; një diagramë elektrike të agregatëve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes; opinionin paraprak të OST-së ose OSSH-së mbi lidhjen e tij me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes së energjisë elektrike; shtrirjen gjeografike të vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria, duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000; një hartë topografike ku të paraqitet gjurma e linjës, që lidh burimin gjenerues me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes në shkallë 1:25000.

b) Në terma ekonomike, studimi duhet të paraqesë një plan biznesi, që demonstron besueshmërinë ekonomike të projektit të propozuar. Plani i biznesit duhet të përcaktojë minimalisht shpenzimet dhe të ardhurat e pritshme, si dhe kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit në muaj. Kostot duhet të ndahen në kategoritë përkatëse: kostot financiare, kostot e ndërtimit (përfshirë kostot lidhur

me fuqinë punëtore, makineritë dhe lidhjen me rrjetin), kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.

c) Në terma financiarë, studimi duhet të paraqesë një plan financiar, që demonstron besueshmërinë financiare të projektit të propozuar. Plan i financiar duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe transparente se si synon aplikuesi të financojë projektin e propozuar. Ai do të përcaktojë minimalisht sasinë e alokuar të kapitalit të vet ndaj burimeve financiare të jashtme të kërkuara, burimet konkrete të financimit nga jashtë dhe një program të detajuar financimi. Aplikuesi do të paraqesë dokumente në formën e një letre interesi, marrëveshje paraprake kreditimi ose çdo dokument tjetër, që vërtetojnë mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase, ose të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione apo financime të tjera).

d) Në terma të impaktit mjedisor dhe social, studimi duhet të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor dhe social të projektit të propozuar. Aplikuesi do të sigurojë informacion lidhur me ndikimin pozitiv ose negativ të projektit mbi përdorimin e tokës, efektet lidhur me ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, emetimin e gazrave në atmosferë, tokë ose ujë, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social të projektit si p.sh. ato për punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukturës ose çdo ndikim tjetër të rëndësishëm mjedisor ose social. Studimi duhet të krahasojë ndikimet mjedisore me normat europiane të mjedisit.

Neni 11

Aplikimi nga një bashkim shoqërisht

1. Aplikimi për një autorizim për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë mund të bëhet edhe nga më shumë se një person në formën e një bashkimi shoqërisht.

2. Në rast se një aplikim është paraqitur nga bashkim shoqërisht, anëtarët e këtij bashkimi shoqërisht do të caktojnë një partner udhëheqës, i cili do të jetë i autorizuar nëpërmjet një prokure të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e bashkimit për të vepruar në emër të tyre për qëllimin e aplikimit.

3. Dokumentet e përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje duhet të paraqiten për të gjithë anëtarët e bashkimit të shoqërisht.

4. Ministria përgjegjëse për energjinë kërkon në këtë rast dokumentacionin e nevojshëm për përgjegjësinë solidare të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, për realizimin e projektit.

Neni 12

Shqyrtimi i dokumenteve të aplikuesit

1. Ministria përgjegjëse për energjinë shqyrton nëse dokumentet e depozituara nga aplikuesi janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë mund të verifikojë besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë i komunikon aplikuesit ose të deleguarit përgjegjës të tij brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së aplikimit pranimin e tij, nëse dokumentet dhe informacioni i paraqitur nga aplikuesi janë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e neneve 7, 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Paraqitja e dokumentacionit të munguar

1. Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e parashikuara në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, ministria përgjegjëse për energjinë i kërkon aplikuesit të paraqesë dokumentacionin e munguar, brenda 15 ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes së aplikimit.

2. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e munguar brenda periudhës së specifikuar në pikën 1 të këtij neni, ministria përgjegjëse për energjinë refuzon aplikimin.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë i kthen aplikuesit të gjithë dokumentacionin e paraqitur në rast refuzimi të aplikimit të tij.

Neni 14
Publikimi i aplikimit

1. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga pranimi i një aplikimi dhe pasi aplikuesi të ketë bërë pagesën e nevojshme për publikim, ministria përgjegjëse për energjinë duhet të publikojë tri ditë me radhë, në tri gazeta kombëtare të publikuara në Tiranë, një njoftim me përmbajtjen e mëposhtme:

- një prezantim të shkurtër të aplikuesit;
- një përshkrim të shkurtër të projektit të propozuar;
- informacion lidhur me atë se ku mund të gjendet nga publiku aplikimi i detajuar;
- adresën e ministrisë përgjegjëse për energjinë, ku mund të dërgohen objeksionet ose komentet lidhur me aplikimin;

- afatin për dërgimin e objeksioneve ose komenteve në ministrinë përgjegjëse për energjinë.

2. Shpenzimet për publikim përballohen nga aplikuesi dhe derdhen në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për energjinë, në bankën e përcaktuar nga kjo e fundit.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron që aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese, si dhe çdo informacion tjetër të jenë të disponueshme për inspektim publik në mjediset e ministrisë.

4. Ministria përgjegjëse për energjinë, duke marrë në konsideratë kërkesën e aplikuesit, mund të vendosë se cilat dokumente ose të dhëna të veçanta do të mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë njohjen e tyre nga publiku.

Neni 15
Objeksionet

1. Çdo person që ka një interes ligjor, mund të paraqesë brenda një muaji nga data e publikimit të parë, sipas pikës 1 të nenit 14 të kësaj rregulloreje, në ministrinë përgjegjëse për energjinë, objeksionet e tij lidhur me një aplikim të bërë sipas kësaj rregulloreje.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë informon aplikuesin për objeksionet, që mund të ketë marrë lidhur me aplikimin e tij dhe kërkon sqarime nga aplikuesi për objeksionet e bëra, brenda 15 ditëve kalendarike.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë nuk merr në konsideratë asnjë objeksion, nëse është bërë më vonë se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me aplikuesin dhe kur është e nevojshme në bashkëpunim me ministrinë e tjera të interesuara në këtë proces, organizon seancë dëgjimore me komunitetin e zonës dhe me pushtetin vendor të qarkut ku do të ndërtohet objekti.

Neni 16
Mbivendosja e vendndodhjeve të aplikimeve

1. Në rast se për të njëjtën vendndodhje paraqiten dy ose me shumë aplikime, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15, ministria përgjegjëse për energjinë, i merr në shqyrtim të gjitha aplikimet, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Komisioni i vlerësimit të aplikimit i krijuar sipas nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje vlerëson të gjitha aplikimet dhe i propozon ministrit përgjegjës për energjinë dhënien e autorizimit paraprak për aplikuesin, që propozon zgjidhjen më të mirë.

3. Ministri përgjegjës për energjinë njofton aplikuesit e tjerë për refuzimin e aplikimeve të tyre sipas pikës 4 të nenit 19 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI III
DHËNIA, ZGJATJA DHE HEQJA E LEJES

Neni 17

Komisioni i vlerësimit të aplikimit

1. Ministri përgjegjës për energjinë, për vlerësimin e një projekti të propozuar, krijon një komision vlerësimi *ad-hoc*, të përbërë nga specialistë me ekspertizën e nevojshme. Kryetar i komisionit caktohet njëri prej drejtuesve të lartë të ministrisë.

2. Me kërkesë të ministrit përgjegjës për energjinë, nëse për vlerësimin e një propozimi kërkohet ekspertizë e veçantë, mund të caktohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të aplikimit edhe specialistë nga ministri ose institucione të tjera.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë, në procesin e vlerësimit të një aplikimi, nëse e konsideron të nevojshme, mund të kërkojë ekspertizë dhe konsulencë të huaj.

4. Ministri përgjegjës për energjinë nxjerr një urdhër për krijimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit të aplikimit.

Neni 18

Vlerësimi i aplikimit

1. Komisioni i vlerësimit të aplikimit, pas kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje për paraqitjen e objeksioneve, merr në shqyrtim aplikimin, duke marrë në konsideratë:

- a) plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur;
- b) aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare të aplikuesit;
- c) sigurimin e stafit të aftë dhe kompetent;
- d) strategjinë kombëtare të energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave ose ndonjë dokument tjetër të politikave energjetike për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë;
- e) rendimentin e burimit gjenerues të energjisë;
- f) sigurimin e shëndetit dhe sigurisë teknike të njerëzve;
- g) plotësimin e kushteve mjedisore sipas legjislacionit në fuqi;
- h) vendndodhjen gjeografike të burimit gjenerues të energjisë përkundrejt sistemit të përgjithshëm kombëtar të prodhimit dhe furnizimit me energji;
- i) mosinterferimin e burimit të ri gjenerues me shfrytëzimin e burimeve gjeneruese ekzistuese ose të atyre burimeve gjeneruese, që janë autorizuar ose që janë në procesin e ndërtimit;
- j) nëse karakteristikat e burimit të ri gjenerues të energjisë sigurojnë koordinim të përshtatshëm me sistemin elektroenergjetik;
- k) zgjidhjen teknike të lidhjes së burimit gjenerues të energjisë me rrjetet e transmetimit ose shpërndarjes;
- l) objeksionet e paraqitura lidhur me aplikimin, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje;
- m) sasinë e energjisë elektrike, por jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit, ose konvertimin e saj në vlerë, që do të jepet falas, në formë *royalty*.

Neni 19

Autorizimi paraprak për vazhdimin e procedurave

1. Komisioni i vlerësimit të aplikimit i paraqet ministrit përgjegjës për energjinë, brenda 3 (tri) muajve nga data e pranimit të aplikimit, një raport lidhur me miratimin ose refuzimin e aplikimit.

2. Ministri përgjegjës për energjinë, në rast të një opinionit pozitiv të komisionit të vlerësimit të aplikimit, i lëshon aplikuesit një autorizim paraprak për vazhdimin e procedurave për marrjen e autorizimit.

3. Autorizimi paraprak për vazhdimin e procedurave përmban:

- a) emrin e aplikuesit;
- b) të drejtën ekskluzive të aplikuesit të bëjë matje ose studime të tjera lidhur me investimet për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë;
- c) periudhën kohore brenda së cilës aplikuesi duhet të përfundojë matjet ose studimet e tjera lidhur me investimin sipas gurmës “b” të kësaj pike.

4. Ministri përgjegjës për energjinë, në rast të një vendimi negativ, njofton aplikuesit për refuzimin e aplikimit.

5. Aplikuesi, të cilit i është refuzuar aplikimi, mund të ankohet te ministri përgjegjës për energjinë brenda 10 (dhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 20

Paraqitja e dokumenteve të tjera

Aplikuesi i pajisur me autorizimin paraprak, sipas pikës 2 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, i paraqet ministrisë përgjegjëse për energjinë, brenda periudhës kohore të përcaktuar në autorizimin paraprak, sipas pikës 3(c) të nenit 19 të kësaj rregulloreje, dokument e mëposhtme:

- a) studimin e plotë të fisibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projektit;
- b) planin e biznesit të projektit;
- c) grafikun e zbatimit të projektit;
- d) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;
- e) lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse vendore ose kombëtare;
- f) dokumentacionin që provon të drejtat e pronësisë së aplikuesit mbi tokën, pronë private, që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Neni 21

Dhënia e autorizimit

1. Ministria përgjegjëse për energjinë shqyrton brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes, plotësinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi, sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë, nëse arrin në përfundimin se të gjitha dokumentet e paraqitura nga aplikuesi, sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje, janë të plota dhe të sakta, i dërgon Këshillit të Ministrave propozimin për miratimin e autorizimit, të shoqëruar me të gjitha dokumentet dhe një kopje të autorizimit paraprak të dhënë sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli i Ministrave shqyrton dhe miraton autorizimin sipas procedurave të tij.

Neni 22

Përmbajtja e autorizimit

1. Autorizimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje, përfshin elementet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

- a) emrin dhe selinë e mbajtësit të autorizimit;
- b) të drejtën e dhënë nga autorizimi (tipin, kapacitetin dhe teknologjinë e burimit gjenerues të energjisë);
- c) vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë;
- d) afatin e autorizimit;
- e) afatin për përgatitjen e studimit të projektit të zbatimit teknik;
- f) të drejtën e institucioneve kompetente shtetërore për të mbikëqyrur dhe monitoruar veprimtarinë e ndërtimit të mbajtësit të autorizimit;
- g) detyrimin që mbajtësi i autorizimit të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj/mujor) pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë;
- h) çdo kufizim lidhur me zonat e mbrojtura;
- i) detyrimin që ndërmjet aplikuesit dhe ministrisë përgjegjëse për energjinë të nënshkruhet një kontratë, lidhur me realizimin e këtij projekti dhe penalitetet në rast mosrealizimi apo transferimi të autorizimit;
- j) detyrimin e mbajtësit të autorizimit, për pagesën e *royalty*, të shprehur nga aplikanti, konform pikës “m” të nenit 18 të kësaj rregulloreje;
- k) autorizimi mund të përfshijë gjithashtu kërkesën që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 23

Detyrimi për dhënien e informacionit

1. Mbajtësi i autorizimit i dërgon ministrisë përgjegjëse për energjinë, çdo 3 (tre) muaj nga data e miratimit të autorizimit, një raport mbi veprimtaritë e tij për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë, pa u kufizuar nga pika 1 e këtij neni, ka të drejtë t'i kërkojë mbajtësit të autorizimit çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e autorizimit.

Neni 24

Zgjatja e afatit të autorizimit

1. Mbajtësi i autorizimit mund t'i paraqesë ministrisë përgjegjëse për energjinë një kërkesë me shkrim për zgjatjen e afatit të autorizimit, duke dhënë arsyet për zgjatjen e kërkuar.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë, nëse e shih të arsyeshme, pranon zgjatjen e afatit të autorizimit dhe vazhdon procedurat për miratimin e saj në Këshillin e Ministrave. Në të kundërt, i propozon Këshillit të Ministrave heqjen e autorizimit.

3. Çdo zgjatje e afatit të autorizimit për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, mund të jepet vetëm një herë dhe mund të jetë jo më e gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit, që përcaktohet në autorizim.

4. Mbajtësi i autorizimit njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për energjinë, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në autorizim, kur ai e ka të qartë se nuk mund të jetë në gjendje të përmbushë afatin përkatës.

Neni 25

Transferimi i autorizimit

1. Autorizimi i dhënë sipas kësaj rregulloreje, për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë, mund të transferohet te një i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave, duke e konsideruar atë si një autorizim të ri.

2. Subjekti që do të pajiset me autorizim duhet të plotësojë dhe të dorëzojë pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë ia paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për dhënien e autorizimit.

4. Transferimi bëhet me kërkesë të mbajtësit të autorizimit ose me kërkesë të një subjekti tjetër, vetëm pasi Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 26 të kësaj rregulloreje, ia ka hequr atë mbajtësit të mëparshëm të autorizimit.

5. Çdo transferim i autorizimit te të tretët, pa miratimin e Këshillit të Ministrave, është i pavlefshëm.

Neni 26

Heqja e autorizimit

1. Këshilli i Ministrave mund t'ia heqë subjektit autorizimin, pa detyrimin për të shlyer financiarisht apo në ndonjë mënyrë tjetër punimet e kryera në rastet e mëposhtme:

- me kërkesë me shkrim të mbajtësit të autorizimit, në raste të veçanta të justifikuara;
- në rast se subjekti i autorizuar nuk ka plotësuar detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në autorizim;

- nëse nuk ka zbatuar grafikun e punimeve dhe nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi, që ministria përgjegjëse për energjinë i bën aplikantit, ky i fundit nuk justifikon mosrealizimin e detyrës dhe nuk dokumenton mundësitë e tij për të përfunduar në datën e përcaktuar objektin ose ndonjë fazë të tij;

- nëse mbajtësi i tij nuk informon siç kërkohet nga neni 24 të kësaj rregulloreje dhe nëse

brenda një afati prej 15 ditësh, pas njoftimit paraprak nga ministria përgjegjëse për energjinë, aplikuesi përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

- nëse vërtetohet se deklaratimet e subjektit të autorizuar nuk janë të vërteta;

- kur për mbajtësin e autorizimit kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”.

2. Këshilli i Ministrave e publikon heqjen e lejes në Fletoren Zyrtare.

KAPITULLI IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Dispozita tranzitore

1. Çdo aplikim i bërë në ministrinë përgjegjëse për energjinë për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni, përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të trajtohet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, me përjashtim të neneve 14 dhe 15.

2. Në rast se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi konstatohet mungesë e informacionit ose dokumenteve të parashikuara në nenet 7, 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, ministria përgjegjëse për energjinë i kërkon aplikuesit të paraqesë dokumentacionin e munguar brenda një afati të caktuar, pavarësisht afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 13 të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Kopjet e autorizimit

Një autorizim lëshohet në tri kopje, prej të cilave një kopje i bashkëngjitet dosjes së mbajtur në arkivën e Këshillit të Ministrave, një kopje e mban ministria përgjegjëse për energjinë dhe një kopje i jepet aplikuesit.

Neni 29

Ndryshime të rregullores

Kjo rregullore është objekt ndryshimi me vendim të Këshillit të Ministrave.

UDHËZIM Nr.40, datë 24.12.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

1. Tarifat e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, është në shumën 10 euro dhe paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës.

2. Tirana International Airport (TIA), në zbatim të Marrëveshjes së koncesionit dhe këtij udhëzimi, kryen të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj tarifë shërbimi në sistemin e IATA-s. Pas këtij regjistrimi, çdo shoqëri ajrore, në momentin e shitjes së biletave, duhet t’i shtojë vlerën e biletës, si dhe ta pasqyrojë në të, edhe vlerën e kësaj tarife shërbimi.

3. Vjelja e kësaj tarife kryhet pavarësisht vendit të shitjes apo mënyrës së shitjes së biletës nga shoqëritë ajrore. Vjelja e tarifës së paguar nga udhëtarët, në momentin që ata blejnë biletën e avionit dhe që derdhet nga ana e shoqërive ajrore, duhet të reflektohet nëpërmjet faturimeve që TIA u lëshon shoqërive ajrore që operojnë në aeroportin “Nënë Tereza”. Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit të pasagjerëve dhe këto dokumente ruhen në TIA dhe shoqërinë ajrore. Shumat e arkëtuara nga TIA, nëpërmjet shoqërive ajrore, derdhen brenda 5 ditëve punë në llogarinë bankare të të ardhurave të thesarit.

4. Mbi tarifat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.

5. Çdo muaj do të bëhet rakordimi i tarifës së mbledhur nga TIA me PKPK Rinas dhe shoqëritë ajrore.

6. Për shërbimin e kryer, TIA përfiton 5% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në Buxhetin e Shtetit.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM

Nr.1412, datë 12.12.2008

PËR RREGULLAT E NUMËRTIMIT TË NDËRTESAVE NË FSHATRA, KUR NUK KA MUNDËSI TË EMËRTIMIT TË RRUGËVE

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9951, datë 10.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, me qëllim zbatimin e një procesi unik të numërtimit të ndërtesave në fshatra, kur nuk ka mundësi emërtimi të rrugëve, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Në zonat rurale do të zbatohet si rregull parimi i numërtimit të ndërtesave, sipas ligjit nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar.

2. Në ato fshatra që nuk kemi mundësi të emërtimit të rrugëve do të zbatohet parimin e pikave 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar.

3. Zyrat e urbanistikës/personat e ngarkuar fillimisht do të përcaktojnë territoret; fshatra apo lagje brenda një fshati, ku nuk ka mundësi të bëhet emërtimi i rrugëve.

4. Fshatrat e përcaktuar në pikën 3 do të klasifikohen si:

- fshatra që janë të përbërë nga lagje;

- fshatra me shtëpi të grupuara si një grup i vetëm i përbashkët.

5. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar pasi të ketë bërë këtë lloj përcaktimi, do të fillojë të bëjë numërtimin e ndërtesave.

6. Kur fshatrat janë të përbëra nga lagje, numërtimi i ndërtesave do të bëhet sipas lagjeve, të cilat më parë duhet të marrin një emër. Emri i lagjes do të zëvendësojë emrin e rrugës edhe në adresë. Numri i çdo ndërtese që ndodhet në këtë fshat do të lidhet me emrin e lagjes së këtij fshati. Numërtimi i ndërtesave do të fillojë me numrin 1 (një) për ndërtesën e parë që ndodhet në hyrje të lagjes dhe do të vazhdojë progresiv. Numërtimi do të ndjekë kahun e lëvizjes së akrepave të orës, me rregull nga jashtë brenda, duke krijuar kështu një spirale që mbyllet në qendër të grupit. Numrat e ndërtesave të çdo lagjeje nuk duhet të përsëriten. Shih fig.1.




Fig.1

Adresa për fshatrat e ndarë në lagje do të shkruhet në këtë formë:

Lagjja GROPAS

Nd.1, H.2, Ap.4

Mucaj, Rremas, Kodi postar

Lushnjë

7. Kur në fshat nuk mund të emërtojmë rrugët dhe ndërtesat klasifikohen si një grup i vetëm i përbashkët, atëherë numërtimi i ndërtesave do të fillojë me numrin 1 (një) për ndërtesën e parë që ndodhet në hyrje të fshatit dhe do të vazhdojë progresiv. Numërtimi do të ndjekë të njëjtat kritere si në pikën 6. Shih fig 2.

FSHATI DRITHAS




Fig. 2

Adresa për këtë kategori fshatrash do të shkruhet në këtë formë:

Nd.2, H.1, Ap.4

Drithas, Sheqeras, Kodi postar

Korçë

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kryetarët e komunave që kanë në përbërje të tyre fshatra të cilat janë subjekt i nenit 21 të ligjit nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.1411, datë 10.12.2008

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË ADRESËS DHE RADHËN E VENDOSJES SË
ELEMENTEVE TË SAJ**

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr.9951, datë 10.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, me qëllim zbatimin e një procesi unik të pasqyrimin të adresës, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

URDHËROJ:

1. Elementet e adresës do të shkruhen sipas kësaj radhe:

- emri i rrugës/bulevardit/sheshit/parkut;
- numri i ndërtesës “Nd”, numri i hyrjes “H”, numri i apartamentit “Ap”, emri i fshatit, emri bashkisë /komunës, kodi postar, emri i rrethit.

Dhe në rastin e Bashkisë Tiranë:

- emri i rrugës/bulevardit/sheshit/parkut;
- numri i ndërtesës “Nd”, numri i hyrjes “H”, numri i apartamentit “Ap”;

- emri i njësisë bashkiake, kodi postar.

TIRANË

Në çdo rast emri i rrugës, si dhe emrat e bashkisë, komunës, njësisë bashkiake dhe rrethet shkruhen me germa të mëdha. Nëse ka shkurtime pas tyre vendoset “.”.

2. Elementet për ndërtesën, hyrjen dhe apartamentin do të shkruhen në një rresht dhe do të ndahen ndërmjet tyre me shenjën “,” ose “;”.

Në rastet kur mungon ndonjë nga këta elemente në shkrimin e adresës do të thotë se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje dhe hyrja ka vetëm një apartament. Në këtë rast do të shkruhet vetëm numri i ndërtesës.

3. Emrat që përcaktojnë elementet fshat/qytet/ njësi bashkiake për Tiranën, komunë/bashki dhe kodi postar, do të shkruhen në një rresht të ndarë midis tyre me shenjën “,” dhe “;”.

4. Emri i rrethit do të shkruhet në rreshtin e fundit në rastet kur kemi adresë brenda vendit dhe kur kemi adresë për jashtë vendit do të shtohet dhe emri i shtetit.

5. Modeli i shkrimit do të jetë sipas rasteve të mëposhtme:

a) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën në bashkinë e Tiranës:

Rr. “MYSLYM SHYRI”

Rr. “MYSLYM SHYRI”

Nd.5, H.2, Ap.12

Nd.5; H.2; Ap.2

Njësia Bashkiake nr.10, Kodi postar

Njësia Bashkiake nr.10; Kodi postar

TIRANË

TIRANË

b) Në rastet kur kemi për të shkruar adresën në një bashki qendër rrethi me emër të njëjtë me rrethin:

Rr. “JANI VRUHO”

Rr. “JANI VRUHO”

Nd.5, H.2, Ap.12

Nd.5; H.2; Ap.12

Kodi postar

Kodi postar

BERAT

BERAT

c) Në rastin e një bashkie me emër të ndryshëm nga rrethi:

Rr. “DELIALLISI”

Rr. “DELIALLISI”

Nd.42, H.1, Ap.3

Nd.42; H.1; Ap.3

SUKTH, Kodi postar

SUKTH; Kodi postar

DURRËS

DURRËS

Rr. “SKËNDERBEU”

Rr. “SKËNDERBEU”

Nd.42, H.1, Ap.3

Nd.42; H.1; Ap.3

LAÇ, Kodi postar

LAÇ; Kodi postar

KURBIN

KURBIN

d) Në rastet e një fshati me emër ndryshe nga emri i bashkisë/komunës:

Rr. “AVNI BAJRAMI”

Rr. “AVNI BAJRAMI”

Nd.24, H.1, Ap.3

Nd.24; H.1; Ap.3

Sheqeras, VRESHTAS, Kodi Postar

Sheqeras; VRESHTAS; Kodi postar

KORÇË

KORÇË

e) Në rastet e një fshati të njëjtë me emrin e komunës:

Rr. “E LISIT”

Rr. “E LISIT”

Nd.12, H.1, Ap.5

Nd.12; H.1; Ap.5

VRESHTAS, Kodi postar

VRESHTAS; Kodi postar

KORÇË

KORÇË

6. Të gjitha institucionet publike, personat juridikë e fizikë zbatojnë modelin e adresës në çdo format zyrtar që kërkohet. Kryetarët e bashkive/komunave u dërgojnë të gjitha institucioneve publike, të gjithë personave juridikë dhe fizikë adresën përkatëse, si dhe lajmërimin sa herë që ajo ndryshohet.

7. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.1445, datë 22.12.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR RREGULLAT E PUNËS NË HARTË PËR NUMËRTIMIN E NDËRTESAVE DHE
PËRCAKTIMIN E ADRESËS SË SHETETASVE NGA BASHKITË/KOMUNAT/NJËSITË
BASHKIAKE”

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës “b” të nenit 61 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, me qëllim zbatimin e një procesi unik adresimi, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për rregullat e punës në hartë për numërtimin e ndërtesave dhe përcaktimin e adresës së shtetasve nga bashkitë/komunat/njësitë bashkiake”.

2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bashkitë/komunat/njësitë bashkiake të Tiranës.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

RREGULLORE
PËR RREGULLAT E PUNËS NË HARTË
PËR NUMËRTIMIN E NDËRTESAVE DHE PËRCAKTIMIN E ADRESËS SË SHETETASVE
NGA BASHKITË/KOMUNAT/NJËSITË BASHKIAKE

1. Përpara fillimit të procesit të numërtimit të ndërtesave, zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar krijon një shtresë (*layer*), në të cilën duhet të pasqyrojë fillimin e çdo PTP-je me shenjën e “shigjetë me ngjyrë jeshile” dhe të mbarimit me “shigjetë me ngjyrë të kuqe”. Kjo përcakton drejtimin/pikënisjen nga ku do të fillojë numërtimi i ndërtesave, adresa e të cilave do të lidhet me PTP-në përkatëse.

2. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar do të analizojë informacionin që paraqitet në hartë me gjendjen aktuale në terren, për ndryshime të mundshme (p.sh. ndërtesa, rrugë, rrugica, sheshe, parqe të reja ose prishje apo transformime të tyre).

3. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar, pasi ka dixhitalizuar të gjitha pjesët e territorit publik dhe pasi ka hedhur të gjitha emërtimet përkatëse për çdo PTP (rrugë / rrugicë / bulevard / shesh/ park / autostradë), në përputhje me rregulloren “Për rregullat e punës në hartë për adresimin e pjesëve të territorit publik nga bashkitë/komunat”, pasqyron në shtresa (*layer*) të veçanta:

- të gjithë gjeometrinë e ndërtesave (gjurmët e objekteve) brenda territorit të

bashkive/komunave. Kjo shtresë (*layer*) titullohet “Ndërtesat” ,

- numrin përkatës të ndërtesave. Shtresa (*layer*) titullohet “Numërtimi i ndërtesave”.

4. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar duhet të përcaktojë saktë informacionin për ndërtesat, që kanë fasadë dhe hyrje/dalje në dy rrugë. Ky informacion duhet të përmbajë:

- numrin e hyrjeve/daljeve të tyre;
- pozicionin e tyre.

Në rastet kur ky informacion nuk është i plotë apo i pasaktë, duhet verifikuar në terren.

5. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar, mbasi ka verifikuar dhe ka azhurnuar të gjitha ndryshimet në hartën e punës, fillon procesin e numërimit, ku si fillim krijon gjashtë shtresa (*layer*) të reja:

a) Në shtresën (*layer*) e parë përcaktohet fasada e ndërtesës, nëpërmjet shenjës rreth, të komandës pikë (*point*), me ngjyrë të kuqe, i cili do të bëjë lidhjen e poligonit të ndërtesës me PTP-në nga e cila do të marrë adresën. Kjo shenjë do të vendoset jashtë poligonit të ndërtesës, nga ana e së cilës kanë pamjen të gjitha hyrjet/daljet për në ndërtesë, duke përcaktuar kështu adresimin e ndërtesës, duke pasur parasysh edhe rastet kur ndërtesa ka funksion të përzier.

b) Në shtresën (*layer*) e dytë përcaktohet drejtimi e hyrjeve/daljeve me shenjën rreth, të komandës pikë (*point*), me ngjyrë blu. Pikat vendosen jashtë poligonit të ndërtesës, përballë vendndodhjes së çdo hyrje/dalje, të cilat do të përcaktohen si të tilla, sipas kriterëve të ligjit nr.9270, datë 29.7.2007 “Për sistemin e adresave”.

c) Në shtresën (*layer*) e tretë do të vendosen numrat, me ngjyrë blu për hyrjet/daljet e ndërtesave, sipas kriterëve të përmendura në nenin 14 pika 2 të ligjit nr.9270, datë 29.7.2007 “Për sistemin e adresave”. Numrat e hyrjeve/daljeve do të vendosen brenda poligonit të ndërtesës.

d) Në përfundim të këtyre do të krijohet shtresa (*layer*) e katërt, në të cilin do të shënohen numrat e çdo ndërtese, me ngjyrë të kuqe. Numri i ndërtesës do të vendoset brenda poligonit të ndërtesës. Numërtimi do të kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 8-24 të ligjit nr.9270, datë 29.7.2007 “Për sistemin e adresave” (shih manualin “Për sistemin e adresave”).

Për fshatrat do t’i referoheni udhëzimit të nr.1412, datë 12.12.2008 të Ministrisë të Brendshme, “Për rregullat e numërimit të ndërtesave në fshatra kur nuk ka mundësi të emërimit të rrugëve”.

dh) Gjatë procesit të adresimit në zyrë/terren, do të përcaktohet edhe vendi i vendosjes së tabelave me emrat e rrugëve, duke respektuar parimet e ligjit për këtë proces. Vendi i cili tregon vendosjen e tabelave me emrat e rrugëve në hartën dixhitale do të jetë në një shtresë (*layer*) të veçantë me titullin “Tabela”, në të cilën do të punohet me një pikë (*point*) me ngjyrë portokalli.

e) Kur të mbarojë adresimi do të krijohet një shtresë (*layer*) e veçantë për përcaktimin e zonave të adresimit sipas kodit 10-shifror zgjedhor. Kjo shtresë do të jetë e formës *polyline* dhe do të ketë kriterin kufi të qendrës së votimit.

ë) Pas kësaj do të krijohet një shtresë (*layer*) e veçantë për përcaktimin e zonave të adresimit sipas kriterit të kodit postar. Kjo shtresë do të jetë e formës *polyline* dhe do të ketë kriterin kufi të territorit që përfshihet në të njëjtën kod postar.

6. Pas krijimit të këtyre “*layer*” përcaktohet numri i apartamenteve në çdo ndërtesë dhe emri i shtetasve që banojnë në çdo apartament, duke krijuar kështu adresën e çdo shtetasi.

7. Për adresimin e saktë të çdo ndërtese/apartamenti i lidhur me emrin e shtetasve që banojnë në adresën përkatëse përdoret formulari tip, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, i cili do të ketë të listuar të gjitha elementet e adresës sipas ligjit, si dhe elemente të tjera të përcaktuara nga DPGJC-ja si të domosdoshme.

8. Grupi i punës i ngritur sipas urdhrit nr.1080, datë 28.8.2008, për adresimin në terren dhe popullimin e çdo apartamenti, ngre grupe të adresimit, numri i të cilave varet nga territori dhe numri i familjeve të njësisë, dhe nga koha në dispozicion për të kryer këtë veprimtari. Për çdo grup caktohet një territor mundësisht i barabartë nga pikëpamja e numrit të familjeve.

9. Grupet e adresimit përbëhen nga dy persona, njëri prej të cilëve të jetë administratori/kryetari i fshatit, i cili e njeh shumë mirë territorin dhe tjetri një punonjës i administratës (ose një person i jashtëm p.sh. shërbimi postar, në varësi të pagesës që mund të bëhet nga bashkitë/komunat).

10. Para fillimit të punës grupet e adresimit pajisen me një dosje, që përmban:

- formularët tip për adresimin e çdo apartamenti përkatës;
- hartë për territorin që do të mbulojnë dhe do të dalin në terren duke filluar nga fillimi i çdo rruge që ata kanë për të plotësuar.

11. Grupi i adresimit fillimisht do të plotësojë formularin tip për çdo ndërtesë. Pasi kemi hedhur të gjithë informacionin, ku përfshihen : rrethi, bashkia/komuna, emri i rrugës, numri i ndërtesës, numri i hyrjeve/daljeve për çdo ndërtesë, do të fillojë numërtimi i apartamenteve dhe vendosja e emrit të personave për çdo apartament. Ky grup do të shkojë në çdo ndërtesë duke identifikuar çdo apartament dhe qëllimin funksional të tij.

12. Në këtë formular do të plotësohet dhe një rubrikë e përbërë nga 16 kuti. Këto kuti përfaqësojnë:

- tri kuti janë për shifrat e numrit të “kodi i zyrës së gjendjes civile”;
- katër kuti janë për shifrat e numrit të rrugës përkatëse, që fillon nga 1 dhe rritet në progresion;
- katër kuti janë për shifrat e numrit të çdo ndërtese, për çdo rrugë ku ajo merr adresë;
- dy kuti janë për shifrat e numrit të hyrjes/daljeve së çdo ndërtese;
- tri shifra janë për numrat e apartamenteve që ka çdo hyrje.

Ky do të jetë dhe kodi personal i adresës për çdo shtetas.

Ky kod do të shërbejë për lidhjen e bazës së të dhënave të regjistrit të adresave me regjistrin kombëtar të gjendjes civile, që do të thotë me çdo shtetas.

13. Grupi i punës i përbërë nga dy persona, pasi ka plotësuar formularin me të gjitha rubrikat e tij në dy kopje, pasi të ketë bërë identifikimin e çdo apartamenti, do të vendosë këtë numër në formular. Pasi të ketë vendosur numrin e apartamentit do të kontaktojë me familjarët, duke u dhënë atyre të plotësojnë emrat për të gjithë personat e familjes që banojnë në apartamentin përkatës.

14. Çdo formular do të plotësohet në dy kopje, nga të cilat një i jepet familjes dhe tjetri do të dorëzohet në zyrën e urbanistikës/personit të ngarkuar.

15. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar, pasi ka marrë këto formularë, hedh këtë informacion në programin *Auto Cad* (në formën dhe mënyrën e përcaktuar në manual) dhe njëkohësisht në programe të posaçme *database*. Kjo *database* do të jetë pjesë e sistemit të adresave. Pasi të krijohet kjo *database* të gjithë këto formular ia kalon zyrës së gjendjes civile përkatëse.

16. Zyra e gjendjes civile, pasi të marrë këta formularë, me përgjegjësi do të plotësojë kodin 16-shifror në rubrikën e regjistrit kombëtar për çdo shtetas.

17. Formularët dhe i gjithë materiali tjetër ruhen në njësinë përkatëse vendore.

18. Ky proces do të përfundojë brenda datës 30.1.2009 dhe brenda datës 5.2.2009 një kopje e materialit duhet të dorëzohet në DPGJC.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

FORMULAR VENDBANIMI (ADRESA)

Adresa

1. Rruga _____
2. Nr.ndërtesës _____
3. Nr.hyrjes _____
4. Apartamenti _____
5. Bashkia/komuna _____
6. Rrethi _____
7. Kodi postar _____

Shënime:

ID	Kodi Z.Gj.C			Nr. rrugës			Nr. ndërtesës			Nr. hyrjes		Nr.Ap.		

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja		
				Dita	Muaji	Viti
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						

Statusi i banesës	
Apartament në pronësi	
Apartament me qira	
Apartament tjetër në pronësi	PO
	JO

Kryefamiljari

Specialisti

* Përcaktimi i shtetasit/shtetasve sipas adresës në bazë familje

VENDIM
Nr.143, datë 29.12.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.13,
DATË 28.1.2008 “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E
CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”
(PARKU EOLIK, PROJEKTI VISU DHE TERPAN)**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ALB WIND ENERGY” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.13, datë 28.1.2008 “Për dhënie e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike” (Parku eolik, projekti Visu dhe Terpan), dhe e konsideroi të drejtë kërkesën e shoqërisë “ALB WIND” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.13, datë 28.1.2008 “Për dhënie e licencës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike “ (Parku eolik, projekti Visu dhe Terpan) bëhen këto ndryshime:

- në pikën 1, afati prej 12 muajsh ndryshohet dhe bëhet 21 muaj;
- në pikën 4, afati prej 36 muajsh ndryshohet dhe bëhet 45 muaj.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.13, datë 28.1.2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.144, datë 30.12.2008

PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES PËR FATURIMIN AFORFE, PËR KLIENTËT FAMILIARË PA MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 52 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “OSSH” sh.a. për kohëzgjatjen e faturimit aforfe të energjisë elektrike në abonentët familjarë pa aparat matës të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Afati i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë të energjisë elektrike, që nuk janë të pajisur me matës, të jetë deri në 31.12.2009.
2. Sasia e energjisë elektrike e faturimit aforfe, për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike (ndarë sipas rretheve) do të jetë e njëjtë me përcaktimet e tabelës sipas vendimit nr.12, datë 28.1.2008.
3. Ky afat i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë, që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike, shtohet në licencën e aktivitetit të shpërndarjes, të dhënë OSSH sh.a. s., pas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.114, datë 1.10.2008.
4. Ngarkohet OSSH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.1352, datë 9.9.2008, shpall të vdekur shtetasin Ferat Bushi, me datë vdekjeje 11.11.1991.

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.3147, datë 10.12.2008, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Flamur Qerim Dautllari, i biri i Qerimit dhe i Fiqirijes, i datëlindjes 5.6.1973, lindur dhe banues në fshatin Sovjan, Korçë. Caktimin e vëllait të tij Festim Qerim Dautllari si kujdestar të veprojë në emër e për llogari të Flamurit, për realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të tij.

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.3263, datë 18.12.2008, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Silvana Pera, e bija e Xhezarit dhe e Raimondës, e datëlindjes 31.7.1987, lindur në Korçë dhe banuese aktualisht në Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit, Korçë. Caktimin e Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit, Korçë si kujdestar të veprojë në emër e për llogari të Silvanës, për realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të saj.

KËRKESË

Shtetësja Danjela Zhura (Gjyli), e bija e Albertit dhe e Myneveres, e datëlindjes 8.10.1983, lindur në Bilisht dhe banuese në Korçë, kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, Roland Gjyli.

KËRKUESJA
Danjela Zhura (Gjyli)

KËRKESË

Shtetasi Kostandin Shkira, i biri i Serafinit dhe i Eftalisë, i datëlindjes 4.2.1947, lindur Sovjan dhe banues në Korçë, kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, Ilia Shkira.

KËRKUESI
Kostandin Shkira

KËRKESË

Shtetësja Haze Veliraj, e bija e Shefit dhe e Qamiles, e datëlindjes 24.1.1969, lindur në Cerkovinë dhe banuese në Skrofotinë, Vlorë, kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, Osman Shefit Veliraj.

KËRKUESJA
Haze Veliraj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.1.2009
Doli nga shtypi më 20.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë